

2.8. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në fushëveprimtarinë e vet të gjërë përfshin aktivitete të ndryshme dhe të shumta. DBPZHR-ja – për shkak të aktiviteteve të shumta e të ndryshme ndahet në tre sektorë:

- ❖ Sektorii Bujqësisë
- ❖ Sektorii Pylltarisë
- ❖ Sektorii Mbrojtjes



SEKTORI I BUJQËSISË

Objektivat kryesore të sektorit të bujqësisë për vitin 2023 janë:

- Hartimin e planeve për zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Hanit të Elezit.
- Ruajtja e tokave bujqësore nga degradimi fizik, kimik dhe ndërtimet në tokat bujqësore.
- Inkurajimi i fermerëve duke i nxitur në investime për rritjen e kapaciteteve prodhuese bujqësore.
- Bashkëpunim me AVUK-in për mbrojtjen e kafshëve shtëpiake, shpendëve, bletëve, etj. nga sëmundjet.
- Hartimin e programeve për orientimin drejt bujqësisë organike, e cila mundëson jo vetëm prodhimin e ushqimit ekologjik dhe të shëndetshëm por edhe mbrojtjen e resurseve natyrore.
- Përkrahje e bujqve: mbjelljen e grurit, misrit, elbit, dredhëzës, mjedrës në blegtori, bletari, shpeztari, etj. Si dhe subvencionimin e tyre.
- Përkrahja e grave që merren me bujqësisë dhe inkurajimin e tutjeshëm të tyre në përfshirjen e aktiviteteve bujqësore.
Organizimi i ligjëratave, seminareve, etj. Të vazhdueshme me fermerët për ngritjen e prodhimtarisë bujqësore (prodhimtari intenzive).
- Promovimi i produkteve bujqësore vendore të fermerëve tanë: perimtari, blegtori, bletari, etj. në përmjet panairit tradicional që organizohet në kuadër të komunës, si dhe nëpërmjet panairove të organizuar nga MBPZHR-ja.

SEKTORI I PYLLTARISË

Objektivat kryesore në sektorin e pylltarisë gjatë vitit 2023:

- Mbrojtja e resurseve pyjore nga dëmtuesit (faktori njeri).
- Pastrimi i pyjeve të ulëta me sipërfaqe prej 20 ha për mes rrallime para tregtare në territorin e fshatit Puset e Nikës për gjatë rrugës dhe Gorancë (vazhdimi i projektit nga viti paraprak).
- Pyllëzimi me fidane të llojit pishë e bardhë dhe pishë e zezë në territorin e fshatit Seqishtë dhe Gorancë në bashkëpunim me APK-së
- Zvogëlimi i numrit të fletëparaqitjeve me një angazhim më të madh në sektorin e mbrojtjes e pyjeve në përmjet bashkëpunimit me Policinë Kosovës.
- Kontroll më të shpeshta për të parandaluar transportet ilegale.
- Sensibilizimi i qytetarëve në shtimi e numrit të kërkesave për prerjet e pyjeve private, për nevojat e tyre.
- Kontrollime më të shpeshta të gurëthyesve që operojnë në territorin e komunës tone për të mos bërë shkatërrimin e pyjeve.
- Ndalimi i hapjeve të rrugëve që bëjnë nxjerrjen e zhavorit në mënyrë të pakontrolluar, pa pëlqim të Kuvendit Komunal.

SEKTORI I MBROJTJES

Objektivat e kryesore në sektorin e mbrojtjes gjatë vitit 2023:

- Mbrojtja e florës dhe faunës (mbrojtja nga gjuetia e pa kontrolluar si dhe peshkimin nëpër lumenj dhe përroskat).
- Zbatimi i kontratës për gjueti e kontraktuar për 10 (dhjetë) vitet e ardhshme në territorin e Hanit të Elezit me shoqatën e gjahtarëve “Syri i Shqiponjës” .
- Përcaktimi i vendëgjuetisë për kafshë i paraparë sipas Ligjit për gjueti-Ligji Nr. 02/L-53 si dhe LIGJI NR. 02/L-85 PËR PESHKATARI DHE AKUAKULTURË
- Shtimi i numrit të punëtorëve, për një punëtor teknik dhe një zyrtar për zhvillimin rural.
- Mbrojtja e pyjeve nga zjarret gjatë stinës së verës.

PLANI I DREJTORISË PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURALI SIPAS MUAJVE:

Nr	Aktivitetet e planifikuara	Koha e aktivitetit	Vendi i aktivitetit
1	Angazhimi në mbrojtjen e pyjeve dhe kontrollime të shpeshta nga dëmtimi I bores së madhe dhe erërave të forta.	Janar-Dhjetor 2023	Territori i Llokmës-Fsh. Neçavcë, Drom Paldenicë dhe në Nj menagjuese “UJI I BARDHË”
2	Njoftimi për prerje të pyjeve private dhe pranimi i kërkesave për prerje në pyjet private	Janar-Mars 2023	Komuna Hani i Elez
3	Përpilimi i raportit 6 mujor dhe vjetor të punës së drejtorisë.	Janar-Dhjetor 2023	Komuna Hani i Elez
4	Kërkesa për ndërrim-destinim të tokës dhe shfrytëzim të tokës.	Janar-Dhjetor 2023	Komuna Hani i Elez
5	Thirrje për aplikim për ndihmë të fermerëve me subvencione nga MBPZHR-ja në ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin agro-rural Masa2: Pagesa direkte për dele, dhi, bletë, lopë, pula, të mbjellura me grurë, misër, arra, lajthi, molla etj.	Mars-Maj 2023	Zyra e Bujqësisë
6	Thirrje për aplikim për ndihmë të fermerëve me subvencione nga MBPZHR-ja në ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin agro-rural Masa2: Ndërmarrjet bujqësore për prodhim të qumështit.	Maj-Korrik 2023	Zyra e Bujqësisë
7	Thirrje për aplikim për ndihmë të fermerëve dhe ekonomive bujqësore. Masa1: Pagesa direkte	Maj-Korrik 2023	Zyra e Bujqësisë
8	Vaksinimi i kafshëve shtëpiake (qenëve dhe macave)	Qershor-Gusht 2023	Territori i Hanit të El
9	Damkosja e drunjve në pyjet private dhe transporti i tyre.	Prill-Dhjetor 2023	Territori i Hanit të El
10	Fillimi me prerje para tregtare dhe pastrami i pyjeve në Njësinë Menaxhuese “Uji i Bardhë”, zona kadastrale Puset e Nikës.	Prill-Nëntor 2023	Territori i Hanit të El
11	Hapja e fushatës “Korrje-Shirje 2023”	Korrik 2023	Territori i Hanit të El
12	Raportimi mbi fushatën e korrje-shirjeve 2023	Korrik-Gusht 2023	Territori i Hanit të El
13	Shpërndarja e aseteve dhe kulturave bujqësore të planifikuara nga OJQ-LAB për vitin 2023.	Mars-Nëntor 2023	Territori i Hanit të El

14	Mbështetje të investimeve në Masën8: Strategjitë për zhvillim local të bazuar në komunitete –Përkrasje për zhvillimin e komunitetit lokal përmes GLV-ve(Grupe lokale të veprimit).	Maj-Shtator 2023	Bizneset e vogëla dhe të mesme Komuniteti OJQ-të
15	Thirrje për aplikim për fermerët dhe ekonomitë bujqësore. Mbështetje për investimenë Masën2: Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural. Përnën-masën 3,4 dhe 5 përSektorin e Pemëtarisë,Perimekulturës dhe Vreshtarisë.	Mars–Shtator 2023	Zyra e Bujqësisë
16	Aplikim për pagesa direkte nga MBPZHR-ja për mbjellje vjeshtore-grurë, misër, dredhëz, mjedër,etj.	Janar-Prill 2023	Zyra e Bujqësisë
17	Subvencionim nga Drejtoria e BPZHR-së .	Prill – Qershor 2023	Zyra e Bujqësisë
18	Panairi i produkteve bujqësore lokale Hani i Elezit 2023	Qershor-Gusht 2023	Komuna Hani i Elezit
19	Furnizimi i qytetarëve me drunjë zjarri me pakicë nga pastrimet e pyjeve dhe furnizimi I objekteve publike me biomasë në qoftë se realizohet projekti I planifikuar për vitin 2023 me energji të rinovushme në Njësinë Menaxhuese“UJI i BARDHË”dhe të shikohet mundësia e dhe në Njësinë menagjuese“Bodoshnjak”.	Prill–Nëntor 2023	Territori i Fshatit Puset Nikës, Gorancës,Paldenicë Krivenik,Seqisht,Neqavci dhe Dromjak.
20	Pyllëzimi vjeshtor në sipërfaqet e zhveshura	Tetor-Dhjetor 2023	Njësia menaxhuese “Uji i Bardhë” Lokacioni- Seqishtë
21	Regjistrimi i demit pyjor në njësitë menaxhuese: “Bodoshnjak”dhe“Uji iBardhë”	Shtator-Nëntor 2023	Komuna Hani i Elezit

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:

Abduraman Bushi